



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN

Nr. 8219 Prot.

Datë 07.07.2022

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr.77, dt.07.07.2022

Mbi shërbimin e gatishmërisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan

Mbështetur në ligjin nr. 97/2016 datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.7905, dt.21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale”, i ndryshuar, ligjin nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore” i ndryshuar, Udhëzimin e Përgjithshëm nr.2, dt.29.12.2016 “Për organizimin dhe koordinimin e punës në prokurori” të Prokurorit të Përgjithshëm, Udhëzimin e Përgjithshëm nr.3, dt.29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori” të Prokurorit të Përgjithshëm, Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan” të miratuar me Urdhërin nr.8 datë 21.01.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan,

Me qëllim :

- *Disiplinimin e rregullave dhe afateve të ndjekjes efektive të çështjeve penale gjatë periudhës së gatishmërisë në prokurori ;*
- *Përcaktimin e rregullave të sakta dhe afateve të qarta për marrjen dhe dorëzimin e shërbimit të gatishmërisë nga prokurorët dhe oficerët ;*
- *Forcimin e rregullshmërisë dhe qartësimin e përgjegjësisë për rastet penale të ngutshme dhe urgjente ;*
- *Evidentimin e personit përgjegjës në rast situatë problematike ;*
- *Kontrollin dhe forcimin e rregullshmërisë në respektimin e afateve të vendosura nga ligji nga prokurorët e çështjeve në kryerjen e veprimeve hetimore në çështjet penale me persona nën hetim të arrestuar në flagrancë apo ndaluar nga policia gjyqësore me iniciativë ;*
- *Kontrollin e zbatimit të afatit të arsyeshëm si pjesë e procesit të rregullt ligjor të garantuar kushtetushmërisht ;*
- *Konsolidimin e dilijencës në hetime nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, sidomos gjatë periudhës së gatishmërisë për çështje urgjente, të ngutshme, të rënda dhe me vendngjarje ;*
- *Përcaktimin e kompetencave të qarta, detyrave rigoroze dhe përgjegjësiive të prokurorëve në rastet e çështjeve penale me persona të arrestuar/ndaluar apo çështjeve të ngutshme, urgjente apo të veprave penale të dukshme me vendngjarje ;*
- *Sanksionimin e rregullave të qarta mbi ndarjen e çështjeve në periudhë gatishmërie ;*
- *Qartësimin e veprimtarisë së prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe administratës së prokurorisë gjatë periudhës së gatishmërisë ;*
- *Forcimin e pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorëve.*

U D H Ë Z O J :

Neni 1

Përkufizime termash

1. **“Shërbim gatishmërie”** është mbajtja në gjendje të tillë e burimeve njerëzore (prokurorit, oficerit të policisë gjyqësore dhe punonjësit

administrativ) dhe mjeteve materiale, për të bërë të mundur zgjidhjen në kohë të problematikave të ngutshme të ndjekjes penale, brenda apo jashtë orarit zyrtar të punës.

2. "**Detyrë e ngutshme**" është çdo detyrë që lidhet me ushtrimin e ndjekjes penale, respektimin e procesit të rregullt ligjor dhe garantimin e të drejtave dhe lirive të personave, e asaj natyre, zgjidhja e së cilës nuk mund të presë ditën pasardhëse të punës.
3. "**Ndërhyrje e prokurorit me veprime hetimore**" do të kuptohen ato raste që lidhen me ngjarje kriminale dhe vepra penale në të cilat kërkohet nga policia gjyqësore për shkak urgjence dhe rasti të ngutshëm kryerja e veprimeve hetimore të menjëhershme nga prokurori, si dhe rastet e veprave penale të dukshme me vendngjarje në të cilat prokurori i gatshëm është paraqitur dhe ka ndërhyrë në veprime hetimore.
4. "**Nivel drejtues i prokurorisë**" do të kuptohet Drejtuesi i Prokurorisë, Zv.Drejtuesi i Prokurorisë dhe Drejtuesi i Seksionit.
5. "**Ngjarje e rëndë kriminale**" do të kuptohen ato ngjarje për të cilat veprat penale që kanë lidhje me këto ngjarje kriminale parashikojnë në maksimum dënimi jo më pak se 10 vjet burgim ose ngjarje sensitive për opinionin publik, pavarësisht masës së dënimit të parashikuar për veprën penale, si dhe ngjarjet e tjera të rënda kriminale që sjellin pasoja të rënda ndaj jetës, shëndetit dhe integritetit fizik të shtetasve si dhe vdekjet e personave nga dhuna e çdo lloji.
6. "**Njoftim**" nëse ky urdhër nuk përcakton shprehimisht njoftimin me shkrim, do të kuptohet cdo formë tjetër njoftimi me anë të mjeteve të komunikimit, telekomunikimit ose komunikimit elektronik.

Neni 2

Planifikimi i gatishmërisë

1. Drejtuesi i Prokurorisë merr masat e nevojshme që në çdo fillim muaji të organizojë shërbimin e gatishmërisë në prokurori, në të cilin të planizohen prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore të seksionit në prokurori dhe punonjësit administrativ të prokurorisë.

2. Urdhëri që miraton shërbimin gatishmërisë dhe grafiku bashkëlidhur tij, i njoftohet prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit dhe shërbimeve dhe punonjësve administrativ të prokurorisë.
3. Policia gjyqësore e shërbimeve të policisë gjyqësore është e detyruar të njoftojë menjëherë prokurorin e gatshëm në rastin kur merr njoftim për vepra penale që parashikojnë një dënim me burgim më të madh se 5 vjet.

Neni 3

Planifikimi i gatishmërisë për nivelin drejtues

1. Drejtuesi i Prokurorisë planizon në shërbim gatishmërie edhe nivelin drejtues të prokurorisë.
2. Drejtuesi i Prokurorisë për nevoja të ndjekjes penale dhe ushtrimit të kompetencave ligjore, procedurale ose administrative, konsiderohet i gatshëm përgjatë të gjithë muajit.
3. Në ditët e festave ose pushimit zyrtar, të shtunave dhe të dielave, nënshkrimi i shkresave përcjellëse në mungesë të Drejtuesit të Prokurorisë, i delegohet dhe kryhet nga Zv.Drejtuesi i Prokurorisë apo drejtuesit e seksioneve të planizuar në shërbim gatishmërie, sipas urdhërit të miratimit të grafikut të gatishmërisë. Në këtë rast, shkresa përcjellëse nënshkruhet me togfjalëshin “Në mungesë dhe me delegim – Zv.Drejtuesi i Prokurorisë/Drejtuesi i Seksionit”.
4. Delegimi i firmës sipas pikës nr.3 të këtij neni është i vlefshëm vetëm për shkresat që përcjellin kërkesat për vleftësim arrestimi në flagrancë/ndalimi dhe caktim mase sigurimi personale për personat e arrestuar në flagrancë/ndaluar nga policia gjyqësore si dhe urdhërin për lirim të menjëhershëm të të arrestuarit/ndaluarit nga policia gjyqësore.
5. Në aktet e shërbimit të gatishmërisë pasqyrohen numrat e kontaktit të drejtuesit të seksionit, prokurorit, oficerit dhe punonjësit administrativ të planizuar në shërbim gatishmërie, të cilat duhet të jenë gjithnjë në gjendje pune dhe të aksesueshëm në çdo moment gjatë periudhës së gatishmërisë.

Neni 4

Organizimi i punës gjatë gatishmërisë

1. Prokurori dhe oficeri i seksionit i planizuar në shërbim gatishmërie, organizojnë punë në mënyrë të tillë që aktiviteti i zakonshëm i tij të mos bëhet pengesë për ndjekjen e problematikës që mund të dalë gjatë shërbimit të gatishmërisë. Ky organizim lidhet përsa i takon përfaqësimit të çështjeve në gjykim për prokurorët, ashtu edhe për organizimin e aktivitetit të ndjekjes penale për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore.
2. Gjatë orarit zyrtar të punës, vëmëndja e prokurorit është zgjidhja e detyrave të ngutshme që lidhen me ndjekjen penale të cilat burojnë rishtaz nga shërbimi i gatishmërisë, pa cënuar dilgjencën në ndjekjen e çështjeve të tjera që ka në verifikim/hetim/gjykim.
3. Pas orarit zyrtar të punës, në ditët e pushimit dhe festave zyrtare, prokurori i gatshëm si dhe njëri prej drejtuesve të seksioneve të planizuar në shërbim gatishmërie, duhet të garantojnë në çdo kohë disponueshmërinë e tyre për zgjidhjen e detyrave të ngutshme që lidhen me ndjekjen penale.
4. Pas orarit zyrtar të punës, në ditët e pushimit dhe festave zyrtare, shërbimi i gatishmërisë realizohet jo domosdoshmërisht duke qëndruar në ambjentet e institucionit. Gjithësesi, prokurori i gatshëm, oficeri i policisë gjyqësore i seksionit i planizuar në gatishmëri, njëri prej drejtuesve të seksioneve të planizuar në shërbim gatishmërie si dhe Drejtuesi i Prokurorisë në ditët e gatishmërisë së tij, duhet të qëndrojnë në një hapësirë të tillë larg institucionit, që do t'i bënte të mundur paraqitjen në institucion apo vendin ku kërkohet prania e tij për shkak të detyrës, në mënyrë sa më të shpejtë dhe gjithësesi brenda 90 minutave.

Neni 5

Veprimtaria e prokurorit të gatshëm

1. Gjatë shërbimit të gadishmërisë, prokurori i gatshëm kryen këto detyra :
 - a. Përmbush të gjitha funksionet, ushtron të gjitha kompetencat dhe i përmbahet të gjitha detyrimeve që parashikon K.Pr.Penale.
 - b. Mban lidhje me shërbimet e policisë gjyqësore dhe komunikon në mënyrë të vazhdueshme me të gjitha strukturat dhe personat e përfshirë në gatishmëri.
 - c. Merr dijeni për veprën penale, kryesisht ose me njoftim nga të tjerët.
 - d. Me marrjen dijeni për detyrën e ngutshme, paraqitet në institucion ose në vendin ku kërkohet detyrimisht prania e tij, për realizimin e detyrës.
 - e. Paraqitet në vendin e ngjarjes për veprat penale që me aktet e tjera është e detyrueshme pjesëmarrja e tij apo kur çmon se për shkak të natyrës së ngjarjes pjesëmarrja është e domosdoshme.
 - f. Njofton drejtuesin e seksionit të planizuar në shërbim gadishmërie dhe/ose Drejtuesin e Prokurorisë për ngjarje të rënda kriminale të ndodhura në juridiksionin e tij.
 - g. Merr njoftime për arrestimet në flagrancë ose ndalimet, duke realizuar pyetjen e të arrestuarit/ndaluarit si dhe kontrollon ligjshmërinë e arrestimeve/ndalimeve, ligjshmërinë e veprimeve të policisë gjyqësore si dhe parashtron kërkesat përkatëse përpara gjykatës të hetimeve paraprake, sipas organizimit në seksione dhe kompetencës së tyre lëndore.
 - h. Në ato ngjarje kriminale dhe vepra penale në të cilat kërkohet nga policia gjyqësore për shkak urgjence dhe rasti të ngutshëm kryerja e veprimeve hetimore të menjëhershme, si dhe në rastet e veprave penale të dukshme me vendngjarje në të cilat prokurori i gatshëm është paraqitur dhe ka ndërhyrë në veprime hetimore, autorizon kontrolle, përgjime, vëzhgime, sekuestrime, u jep zgjidhje ligjore probleme të ngutshme brenda kompetencave të tij, kontrollon ligjshmërinë dhe kryen vleftësimet e nevojshme mbi veprimtarinë e policisë gjyqësore si dhe kryen çdo veprim tjetër hetimor që çmon të nevojshëm.

- i. Në rastet e ndërhyrjes me veprime hetimore urgjente, drejton, koordinon, organizon dhe kontrollon veprimtarinë e policisë gjyqësore të seksioneve dhe shërbimeve si dhe kryen vet veprimet hetimore që çmon të nevojshme.

Neni 6

Ndarja e çështjeve penale gjatë gatishmërisë

1. Drejtuesi i Prokurorisë, i kalon për ndjekje prokurorit të gatshëm, materialet e referuara nga policia gjyqësore me person nën hetim të arrestuar apo ndaluar, si rregull duke marrë në konsideratë vlerësimin e veprës/veprave penale të referuara si dhe ndarjen e prokurorëve nëpër seksione.
2. Kriter përcaktues për t'i kaluar për ndjekje prokurorit të gatshëm materialet e referuara me arrestim në flagrancë apo ndalim të kryer nga policia gjyqësore do të merret data dhe ora e ndodhjes së ngjarjes të pasqyruara në aktin që dokumenton njoftimin e policisë gjyqësore për ngjarjen, procesverbalin e kqyrjes së vendit të ngjarjes ose procesverbalin e kallëzimit të faktit penal.
3. I caktohen drejtpërdrejtë për ndjekje prokurorit të gatshëm duke mos i'u nënshtruar procedurës së shortit :
 - a. Referimet dhe kallëzimet penale që kërkojnë veprime të menjëhershme, pra çështjet penale që lidhen me ngjarje kriminale dhe vepra penale në të cilat kërkohet nga policia gjyqësore për shkak urgjence dhe rasti të ngutshëm kryerja e veprimeve hetimore të menjëhershme nga prokurori ;
 - b. Procedimet penale që lidhen me vepra penale të dukshme me vendngjarje në të cilat prokurori i gatshëm është paraqitur dhe ka ndërhyrë në veprime hetimore urgjente ;
 - c. Materialet e ngutshme të referuara për hetim pas orarit zyrtar të punës, në ditët e pushimit dhe festave zyrtare ;
 - d. Kallëzimet penale të parashtruara verbalisht nga kallëzuesi ku procesverbali për kallëzimin e veprës penale është mbajtur nga vet prokurori i gatshëm.

4. Në rastet e parashikuara nga pika 3 e këtij neni, kur çështja i caktohet prokurorit të gatshëm për shkak gatishmërie, ky prokuror si rregull do të zgjidhë çështjen deri në fund.
5. Prokurori i gatshëm dokumenton kallëzimin verbal të kallëzuesit për veprat penale që janë kompetencë lëndore e seksionit ku prokurori bën pjesë, nëpërmjet procesverbalit përkatës i cili i dorëzohet menjëherë, së bashku me aktet e tjera, Drejtuesit të Prokurorisë për të bërë shënimet përkatëse për Zyrën e Regjistrimit.
6. Të gjitha materialet e përcaktuara në këtë nen ndjekin rrugën administrative të përcaktuar në aktet e tjera të brendshme të prokurorisë të cilat janë në fuqi.
7. Prokurori i gatshëm, ndjek çështjen e marrë për shkak të shërbimit të gatishmërisë edhe në seancën gjyqësore të vleftësimit të arrestit/ndalimit dhe caktimit të masës së sigurimit si dhe është përgjegjës për përpilimin dhe dërgimin e urdhërit përkatës të ekzekutimit për zbatim pranë policisë gjyqësore dhe/ose IEVP përkatëse, pavarësisht datës së mbarimit të shërbimit të gatishmërisë për të, e pasqyruar kjo në grafik.
8. Për çdo situatë dhe në çdo rast prokurorët dhe Drejtuesi i Prokurorisë kanë detyrimin të zbatojnë me përpikmëri rregullat e vendosura në K.Pr.Penale dhe ligjin nr.97/2016 që kanë të bëjnë me përjashtimin, heqjen dorë ose zëvendësimin e prokurorit nga një çështje penale.

Neni 7

Veprimtaria e oficerit të seksionit të planizuar në gatishmëri

1. Gjatë shërbimit të gadishmërisë, oficeri i seksionit të policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, i planizuar në shërbim gatishmërie, ushtron të gjitha kompetencat dhe përmbush të gjitha detyrimet e përcaktuara në K.Pr.Penale, ligjin nr.25/2019 dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore.
2. Oficeri i policisë gjyqësore i seksionit, i planizuar në shërbim gatishmërie, i pëmbahet të gjitha urdhërimeve të përcaktuara ndaj tij në Urdhërin nr.37, datë 20.07.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë

“Për funksionimin e seksionit të policisë gjyqësore dhe shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit, në strukturën e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Policinë e Shtetit dhe të Drejtorisë së Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve Tiranë, gjatë kryerjes së veprimeve të para apo urgjente hetimore në juridiksionin territorial të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”.

3. Oficeri i policisë gjyqësore i seksionit, i planizuar në shërbim gatishmërie, i pëmbahet të gjitha urdhërimeve të përcaktuara ndaj tij në Urdhërin nr.48, datë 28.09.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë *“Për mënyrën e veprimit të oficerëve të seksionit të policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan në marrjen e kallëzimeve dhe ankimeve për vepra penale dhe referimin e materialeve të para hetimore në rastet e kallëzimeve dhe ankimeve për vepra penale drejtpërdrejtë në prokurori”.* Në këtë urdhër termi *“Drejtuesi i Seksionit Z.Alfred Shehu zëvendësohet me termin Zv.Drejtuesi i Prokurorisë”.*

Neni 8

Veprimtaria e administratës gjatë gatishmërisë

1. Punonjësit administrativ të prokurorisë, gjatë periudhës në të cilën janë planifikuar në gatishmëri, por edhe gjatë veprimtarisë normale të punës ditore, veprojnë mbi bazën e parimit të fleksibilitetit në organizimin e punës së tyre. Këta punonjës i japin përparësi kryerjes së detyrave të tyre që lidhen me veprimtarinë e prokurorit dhe/ose oficerit të gatshëm për çështje urgjente, të ngutshme dhe për ngjarje të rënda kriminale, duke racionalizuar këtë veprimtari urgjente me veprimtarinë normale të tyre si dhe me përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga akte të tjera të brendshme që janë në fuqi.
2. Kancelarja e prokurorisë ngarkohet të menaxhojë veprimtarinë administrative me qëllim shmangien e situatave të mbingarkesës në

punë ose bllokimit për shkak të saj, për punonjës të caktuar të administratës.

Neni 9

Periudha e gatishmërisë

1. Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan shërbimi i gatishmërisë fillon në orën 08.00 të datës së parë të pasqyruar në grafik dhe përfundon në orën 08.00 të datës së fundit të pasqyruar në grafik për nivelin drejtues, prokurorët, oficerët e seksionit dhe punonjësit administrativ të planizuar në shërbim gatishmërie.

Neni 10

Pagesat dhe përfitimet e tjera ligjore

1. Pagesat ose përfitimet e tjera ligjore për shkak të qëndrimit në detyrë pas orarit zyrtar të punës ose në ditët e pushimit dhe festave zyrtare, për prokurorët, oficerët e seksionit dhe punonjësit administrativ të planizuar në gatishmëri, kryhen sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 11


Dispozita të fundit

1. Drejtuesi i Prokurorisë, Zv.Drejtuesi i Prokurorisë, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe shërbimeve të policisë gjyqësore si dhe punonjësit administrativ të prokurorisë janë përgjegjës për zbatimin e disponimeve të këtij udhëzimi.
2. Çdo veprim ose mosveprim në kundërshtim me sa më sipër përbën shkak për përgjegjësi sipas ligjit.

3. Ngarkohet Zv.Drejtuesi i Prokurorisë për të ndjekur zbatimin e përcaktimeve të këtij udhëzimi dhe detyrimeve të tjera ligjore dhe nënligjore nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksionit dhe shërbimeve. Në çdo rast Zv.Drejtuesi i Prokurorisë informon me shkrim Drejtuesin e Prokurorisë për problematikat e hasura.
4. Me këtë udhëzim të njihen të gjithë prokurorët, oficerëve të policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe pranë shërbimeve në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan dhe Komisaritet e Policisë Elbasan, Gramsh, Peqin, Cërrik, Librazhd si dhe pranë të gjitha shërbimeve të policisë gjyqësore në institucione të tjera. Një kopje e këtij udhëzimi i 'u komunikohet nëpërmjet postës elektronike zyrtare @pp.gov.al. Ngarkohet specialisti IT me kryerjen e njoftimit.
5. Një kopje e këtij urdhëzimi i dërgohet Prokurorisë së Përgjithshme për publikim në web në zbatim të nenit 46/5 të ligjit nr.97/2016.
6. Shfuqizohet cdo akt tjetër për pjesën që bie në kundërshtim me këtë udhëzim.
7. Ky udhëzim hyn në fuqi më datë 07.07.2022

DREJTUES I PROKURORISË

Kreshnik AJAZI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN

Nr 8221 Prot.

Elbasan, më 07.07.2022

Lënda: Dërgohen për njohje dhe zbatim Udhëzimi i Drejtuesit të Prokurorisë nr.77, datë 07.07.2022

Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan
Drejtorisë së AMP në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan ✓
Drejtorisë së SH.K.B.B Tiranë

Bashkëlidhur ju dërgojmë për njohje dhe zbatim Udhëzimin e Përgjithshëm nr.77, datë 07.07.2022 i Drejtuesit të Prokurorisë mbi “Per sherbimin e gatishmerise ne Prokurorine prane Gjykates se Shkalles se Pare Elbasan”.

Merrni masa që me këto urdhëra të njihen strukturat tuaja hetimore.

Duke i'u uruar punë të mbarë !

DREJTUESI I PROKURORISË

Kreshnik AJAZI

